



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500002/16

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për respektimin e legjislacionit nga Shoqëria Përmbartimore "___" shpk për rastin e shtetasit A. S.*

Drejtuar: **Ministrisë së Drejtësisë**
Drejtorisë së Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe të Profesioneve të Lira
Drejtorit
Z. Bledar KABASHI

TIRANË

I nderuar Z. Kabashi,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën e shtetasit A. S., i cili pretendon se Shoqëria Përmbartimore "___" ka llogaritur gabim masën e sekuestros mbi pagën e tij mujore.

Nga dokumentacioni që kemi administruar deri tani rezulton se, në ngarkim të shtetasit A. S. janë caktuar nga gjykata dy detyrime në të holla: një detyrim ndaj një banke të nivelit të dytë për një kredi të pashlyer dhe një detyrim ndaj ish bashkëshortes për ushqimin e fëmijëve.

Sipas shtetasit A. S. ai nuk mund të paguajë detyrimin për ushqim pasi ky detyrim nuk është llogaritur nga Shoqëria Përmbartimore "___". Shuma në të holla e mbetur pas ndalesës që i bëhet pagës mujore për të shlyer detyrimin ndaj bankës nuk mjafton për të jetuar dhe shlyer detyrimin për ushqim. Gjithashtu ankuesi pretendon se masa e sekuestrimit të pagës mujore çënon minimum jetik të përcaktuar në Direktivën nr. 46 Prot., datë 19.01.2015 të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privat.

Referuar nenit 537 të Kodit të Procedurës Civile, kur debitori duhet të shlyejë më shumë se një kredi, përmbartuesi përgatit një program të shlyerjes së debive sipas radhës së preferimit. Radha e preferimit përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil. Sipas përcaktimeve të këtij neni, detyrimi për ushqim shlyhet para detyrimit për kredinë bankare. Në të njëjtën kohë përmbartuesi duhet të ketë parasysh që, kur sekuestron pagën e debitorit nuk duhet të çënojë minimumin jetik (neni 533 i KPrC). Shuma e minimumit jetik parashikohet në Direktivën nr. 46 Prot., datë 19.01.2015 të nxjerrë nga Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë që është në masën 22.000 lekë. Pra, për

rastin në fjalë, përmbaruesi privat duhet fillimisht të mos pengonte debitorin të shlyente në mënyrë vullnetare detyrimin për ushqim dhe me pjesën e mbetur të pagës, pa cënuar minimumin jetik, të shlyente detyrimin për kredinë bankare.

Përmbaruesit gjyqësorë privat duhet të kryejnë veprimtarinë e tyre sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore (neni 2 i Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "*Për shërbimin përmbarimorë gjyqësor privat*").

Nga hetimi i deritanishëm rezulton se, Shoqëria Përmbarimore "___" nuk ka vepruar sipas legjislacionit të lartpërmendur për rastin e shtetasit A. S. Ky shtetas është penguar nga veprimet kufizuese të përmbaruesit për shlyerjen vullnetare të detyrimit për ushqim si dhe është cënuar minimumi jetik kur është vendosur sekuestro mbi pagën e tij. Kjo provohet nga vërtetimi për ndalesat e përmbarimit i lëshuar nga OSHEE, punëdhënësi i shtetasit A. S.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni fotokopje të vendimit të gjykatës për caktimin e detyrimit për ushqim në ngarkim të shtetasit A. S., të urdhërit për vënien e sekuestros mbi pagën e tij dhe vërtetimin e OSHEE për ndalesta mbi pagën për periudhën Shkurt 2015 – Maj 2016.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në nenin 3/1 dhe 10 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 "*Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat*",

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Marrjen e masave për respektimin e legjislacionit nga Shoqëria Përmbarimore "___" shpk për rastin e shtetasit A. S.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI